

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11) и („Службен весник на Република Северна Македонија“ 96/19 и 110/19), како и врз основа на член 50 став 6 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/2019) министерот за образование и наука донесе скратена наставна програма по наставниот предмет Албански јазик за VII одделение на деветгодишното основното образование за учебната 2020/2021 година.

## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor për lëndën **Gjuhë shqipe** bazohet në objektivat / rezultatet e pritura të parapara me programin mësimor për lëndën mësimore **Gjuhë shqipe klasa VII për arsimin fillor**, e cila realizohet rregullisht në përputhje me planin mësimor të përcaktuar.

Me këtë program të shkurtuar përcaktohen fusha të caktuara programore dhe përmbajtje mësimore që duhet të realizohen në **159 ditë** mësimdhënie, gjatë së cilës sigurohet fondi i parashikuar javor i orëve mësimore të përcaktuara në programin e rregullt mësimor, përkatësisht për këtë lëndë mësimore parashihen **4 orë** në javë me një fond total prej **128 orësh** edhe atë:

- Gjuhë **45 orë**;
- Letërsi dhe lektyrë **45 orë**;
- Të shprehurit dhe krijimtaria **30 orë**;
- Kultura e medias **8 orë**.

Ky program i shkurtuar mësimorë shfrytëzohet gjatë të mësuarit të lëndës së Gjuhës shqipe për arsimin fillor dhe e njejta është pikë fillestare dhe bazë pedagogjike për mësuesit për zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në lidhje me planifikimin dhe përgatitjen e planeve vjetore dhe ditore, si dhe përgatitjen e menjëhershme për punë.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga objektivat/ rezultatet e pritura, konceptet, veprimtaritë dhe metodat e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyrë e temave dhe njësive mësimore

Numri rendor i përmbajtjes mësimore	FUSHA PROGRAMORE : GJUHË – 45 orë
	<b>KREU I Gjuha shqipe – 5 orë</b>
1.	Vjetërsia e gjuhës shqipe
2.	Klasat e fjalëve
	<b>KREU II Grupi emëror – 12 orë</b>
3.	Emri - kategoritë gramatikore
4.	Përcaktorët e emrit
5.	Mbiemri dhe ndajfolja - kategoria e shkallës
6.	Përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra
7.	Llojet e tjerë të përemrave (lidhor, dëftor, pronor, pyetës dhe i pacaktuar)
8.	Fjalët e prejardhura dhe të përbëra
	<b>KREU III Folja – 8 orë</b>
9.	Zgjedhimi dhe format e foljes
10.	Mënyra dëftore
11.	Pjesorja, përcjellorja dhe paskajorja
	<b>KREU IV FunkSIONET gramatikore – 8 orë</b>
12.	Fjalia e thjeshtë
13.	Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali
14.	Rrethatorët dhe llojet e tyre në fjali
	<b>KREU V Struktura e fjalisë – 4 orë</b>
15.	Llojet e fjalive
16.	Fjalia e përbërë
	<b>KREU VI Fjalori dhe stili – 4 orë</b>
17.	Stili i ligjërimit dhe stili funksional
18.	Kërkimi i fjalëve në fjalor

	<b>KREU VII Drejtshkrimi – 4 orë</b>
19.	Përdorimi i drejt i trajtave të shkurtra dhe i nyjës së përparme
20.	Shkrimi i datave
	<b>FUSHA PROGRAMORE : LETËRSI DHE LEKTYRË – 45 orë</b>
	<b>1. Poezia – 15 orë</b>
21.	Lirika popullore (këngët e djepit, të dasmës dhe të dashurisë)
22.	Strofa, vargu dhe rima
23.	Llojet e poezive lirike – himni, poezia sociale, elegjia
24.	Figurat letrare: <ul style="list-style-type: none"> <li>• metafora</li> <li>• personifikimi</li> <li>• alegoria</li> <li>• hiperbola</li> </ul>
	<b>2. Proza – 16 orë</b>
25.	Përralla, miti, legjenda
26.	Romani
27.	Kompozicioni i veprës epike: <ol style="list-style-type: none"> <li>a) paraqitja e veprimit</li> <li>b) thurja e veprimit</li> <li>c) kulminacioni</li> <li>d) peripecia</li> <li>e) shthurja e veprimit</li> </ol>
28.	Llojet e tjera epike: <ul style="list-style-type: none"> <li>• gojëdhënat</li> <li>• fjalët e urta</li> </ul>
29.	Personazhi - portretizimi i jashtëm dhe i brendshëm

30.	Fabula, tema dhe ideja veprës epike
<b>3. Drama – 6 orë</b>	
31.	Drama (aktrimi i tekstit dramatik)
32.	Dialogu dhe monologu si formë e të shprehurit të aktorit
33.	Llojet e dramës: <ul style="list-style-type: none"> <li>• tragjedia</li> <li>• komedia</li> <li>• radio drama</li> </ul>
<b>4. Lekyra – 8 orë</b>	
34.	Lekyra ( 4 të detyrueshme + 2 zgjedhore)
<b>FUSHA PROGRAMORE: TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA – 30 orë</b>	
35.	Diskutimi si lloj i komunikimit
36.	Tregimi me kronologji të saktë
37.	Ritregimi kreativ
38.	Përshkrimi
39.	Njoftimi: lajmërimi dhe lajmi
<b>Hartimet me shkrim– 6 orë</b>	
40.	Dy hartime të detyrueshme gjatë vitit shkollor
<b>FUSHA PROGRAMORE: KULTURA E MEDIËS – 8 orë</b>	
41.	Mediet e shkruara dhe ato elektronike
42.	Interneti
43.	Biblioteka

### 3. Udhëzime didaktike

Planifikimi i mësimdhënies nga lënda e **Gjuhës shqipe** për arsimin fillor duhet të jetë në korelacion me planin mësimor dhe programin e shkurtuar mësimor të për këtë lëndë dhe duhet të përfshijë përmbajtjet programore të të gjitha fushave edukativo-arsimore (Gjuhë, Letërsi dhe lektyrë, Të shprehurit dhe krijimtaria dhe Kultura e medias).

Gjatë realizimit të qëllimeve dhe rezultateve nga të mësuarit, roli i arsimtarit është shumë domethënës sepse ky program i shkurtuar mësimor jep mundësinë e lidhshmërisë së përmbajtjeve, metodave të mësimin dhe aktivitetet e nxënësve.

Përmbajtja e programit të shkurtuar nga lënda e **Gjuhës shqipe** për arsimin fillor është konceptuar në mënyrën që parashikon realizimin e saj në numër më të vogël të ditëve të mësimin dhe të orëve mësimore. I njëjti mundëson gjithashtu korelacion me planifikim racional të mësimdhënies edhe me lëndët e tjera mësimore, p.sh: me lëndët e gjuhëve të tjera (në planifikimin integral me përmbajtjet nga gjuhët e huaja që mësojnë nxënësit); me historinë (kur nxënësit njihen me zhvillimin historik të gjuhës); me gjeografinë (kur nxënësit njihen me dialektet e gjuhës shqipe); me arsimin figurativ (nga paraqitja artistike e personazheve dhe ngjarjeve nga tekstet letrare të interpretuara); me arsimin muzikor (përmes përmbajtjeve që lidhet me rimën dhe figurat letrare); etj.

Korelacioni dhe racionalizimi lidhur me planifikimin e mësimdhënies sipas programit të shkurtuar mësimor nga lënda e Gjuhës shqipe për arsimin fillor, realizohet si në vetë fushën programore ashtu edhe në mes të fushave dhe nënfushave programore. Shembull, në fushën programore **Gjuhë**, korelacioni i njësive mësimore mund të bëhet në atë mënyrë që kur të realizohet njësia mësimore **“Përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra”** mund të ketë lidhshmëri me njësinë mësimore **“Përdorimi i drejt i trajtave të shkurtra dhe i nyjës së përparme”**. Korelacioni, përkatësisht lidhshmëria, mund të bëhet edhe mes dy fushave programore edhe atë mes fushës programore **Gjuhë** dhe fushës programore **Letërsi dhe lektyrë** (ose mes dy fushave tjera). Shembull, mund të ketë korelacion mes njësisë mësimore **“Fjalja e thjeshtë”** ose **“Fjalja e përbërë”** dhe njësisë mësimore **“Përralla, miti, legjenda”**. Korelacioni dhe racionalizimi në lidhje me planifikimin e mësimin mund të jetë evidente edhe mes tri fushave programore edhe atë mes fushës programore **Letërsi dhe lektyrë, Të shprehurit dhe krijimtaria dhe Gjuhë**, ku nëpërmjet teksteve të ndryshme letrare mund të ndërlidhen njësitë mësimore **“Romani”** me njësinë mësimore **“Tregimi me kronologji të saktë”** e më pastaj edhe me njësinë mësimore **“Emri – kategoritë gramatikore”**. Këto janë vetëm disa shembuj se si duhet të bëhet korelacioni, gjegjësisht, lidhshmëria në një fushë programore ose mes disa fushave

programore. Mësimdhënësve ju jepet liria e kreativitetit që vetë të mund të bëjnë lidhjen, gjegjësisht, integrimin dhe korelacionin e përmbajtjeve të dhëna në këtë program mësimor në përputhje me rrethanat në të cilët punojnë si dhe në bazë të përvetësimit të materialit mësimor nga nxënësit dhe përparimit të tyre. Në këtë mënyrë pra, krijohet një kohezion i fuqishëm i materialit mësimor nga vetë lënda mësimore, përmes një lidhje logjike dhe të njëpasnjëshme të njësive mësimore që është objekti i të mësuarit, njëherësh edhe realizim i mirëfilltë i qëllimeve programore.

Korelacioni dhe racionalizimi mund të realizohet edhe gjatë përsëritjes dhe ushtrimeve të ndryshme me shembuj nga tekstet poetike ose proza nëpërmjet të shprehurit me gojë dhe me shkrim, ku duhet të aplikohen dhe kontrollohen njohuritë e fituara nga morfologjia, sintaksa, fjalori, stili dhe drejtëshkrimi. Shembull, pas analizës së një teksti nga libri shkollor, nxënësve mund t'ju jepet detyrë në një pasus të veçantë të teksit, të gjejnë dhe të nënvizojnë emrat e më pas t'i shkruajnë në fletoret e tyre duke përcaktuar gjininë dhe numrin e emrave. E njëjta mund të përdoret edhe për mbiemrat, për përemrat, foljet, përcaktorët e rrethanorët. Gjithashtu korelacioni dhe integrimi mund të zbatohen duke ju dhënë detyrë nxënësve të lexojnë vepra poetike në të cilat janë përdorur figurat letrare që kanë mësuar (metafora, personifikimi, alegoria, hiperbolla), e më pas, duke i nënvizuar ato të jenë në gjendje të bëjnë dallimin mes këtyre figurave letrare.

Roli kryesor i korelacionit mes njësive mësimore është që të sigurohet një tërësi njohurishë që janë paraparë të realizohen me këtë program të shkurtuar mësimor i cili është konceptuar si një sistem plotësisht i integruar i përmbajtjeve të ndërthurura në formë vertikale dhe horizontale, koncepteve dhe aktiviteteve përmes:

- lidhjes së vazhdueshme të njohurive të fituara jashtëshkollore të nxënësit me atë që mësohet në shkollë;
- lidhjes së vazhdueshme të përmbajtjeve me njëra-tjetrën, koncepteve dhe aktiviteteve (në kuadër të më shumë lëndëve mësimore ose në kuadër të vetë lëndës);
- lidhjes së vazhdueshme të asaj që është mësuar tashmë me atë që mësohet tani.

*Korelacioni vertikal* nënkupton atë që mësohet si material i ri mësimor. Ai duhet të bazohet në diçka që tashmë është i njohur nga më parë (qoftë ajo në lidhje me përvojat e mëparshme shkollore apo jashtë shkollore).

*Korelacioni horizontal* nënkupton vendosjen e lidhjeve ndërmjet përmbajtjeve ose koncepteve të ngjashme ose të njëjta nga fusha të ndryshme. Mënyra e tillë në të vërtetë paraqet të mësuarit përmes krahasimit, gjetjes së ngjashmërive dhe dallimeve, bashkëngjitjeve, kategorizimit, plotësimit, etj. Për realizimin e suksesshëm të këtij programi të shkurtuar mësimor si një strukturë logjike është i domosdoshëm edhe korelacioni vertikal edhe ai horizontal.

Gjatë korelacionit dhe racionalizimit të përmbajtjeve mësimore, duhet t'i kushtohet vëmendje njohurive të fituara më parë nga ana e nxënësve, moshës, periudhës së tyre të zhvillimit, aftësive të tyre konjuktive, interesit të treguar si dhe ritmit me të cilin ata zotërojnë materialin e ri mësimor. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nxënësve që përparojnë më ngadalë në mësim, me qëllimin e vetëm që të njejtit të kenë sukses për të arritur minimumin e kërkuar të shkrim-leximit funksional sipas objektivave të dhëna për secilën periudhë arsimore.

***Si duhet të mësojnë nxënësit?*** – Bazuar në programin e shkurtuar mësimor nga lënda e Gjuhës shqipe për arsimin fillor, nxënësit duhet të mësojnë:

*Të kuptojnë* – nëpërmjet lidhshmërisë së asaj që mësohet dhe asaj që përjetohet në jetë dhe përmes asaj që mësohet dhe asaj që është mësuar më parë (nga lënda e njejtë ose nga lëndët e tjera).

*Të zgjidhin probleme* – duke mbledhur dhe analizuar fakte dhe të dhëna në mënyrë të pavarur; të parashtrojnë pyetje përkatëse vetes e të tjerëve dhe të hartojnë plane për zgjidhjen e ndonjë problemi të veçantë.

*Në mënyrë divergjente* - nëpërmjet të të kuptuarit dhe të propozuarit e zgjidhjeve të reja dhe lidhshmërisë së përmbajtjeve dhe tërësive të reja.

*Në mënyrë kritike* – duke përzgjedhur fakte dhe të dhëna individuale sipas rëndësisë së tyre dhe duke krijuar argumente të përshtatshme.

*Në mënyrë kooperative* – nëpërmjet bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me mësimdhënësin dhe me nxënësit e tjerë; nëpërmjet diskutimit, shkëmbimit e respektimit të mendimeve dhe argumenteve të nxënësve tjerë.

Në planifikimin e mësimdhënies rëndësi të veçantë duhet t'u jepet niveleve të ndryshme të vështirësisë të të gjitha përmbajtjeve programore në kuadër të këtij programi të shkurtuar mësimor, i cili është nxjerrë nga vendosja e objektivave që duhet të jetë bazë e planifikimit të procesit mësimor. Është e pamundur që të gjitha përmbajtjeve mësimore t'u kushtohet vëmendje e njejtë, por qasja ndaj tyre nga mësimdhënësi duhet të jetë në atë mënyrë që nxënësit të fitojnë njohuri të qëndrueshme të cilët do t'i zbatojnë në arsimimin e mëtutjeshëm dhe pas përfundimit të tij. Gjatë planifikimit, gjithashtu, si pikënisje duhet të jetë paraqitja e përmbajtjes mësimore, afati i nevojshëm kohor për realizimin e tij si dhe niveli i arritjes së qëllimeve të përcaktuara.

Për sa i përket hartimeve, theksojmë se në vend të 3 (tri) do të realizohen vetëm 2 (dy) hartime edhe atë një në gjysmëvjetorin e parë dhe një në gjysmëvjetorin e dytë. Ndërsa në lidhje me lekturat, parashihet që në **klasën VII** të realizohen 4 lektura të detyrueshme + 2 zgjedhore. Kur realizohet vepra letrare nga lektura, rekomandojmë që ritregimi i



fabulës dhe i pjesëve të lexuara nga lektyra të bëhet mbi përcaktimin e: temës, motivit, idesë, përshkrimit, personazheve dhe karakteristikave të tyre, naratorit, etj.

**Ndjekja dhe vlerësimi i nxënësve** është pjesë e rolit profesional të mësuesit. Nga ai pritet që në kontinuitet të ndjek dhe të vlerësoj: procesin e mësimdhënies dhe të të nxënës, rezultatet e të mësuarit si dhe punën vetanake. Ndjekja e avancimit dhe vlerësimit të të arriturave të nxënësit është formative dhe sumative. Përveç mënyrave të zakonshme të ndjekjes dhe të vlerësimit me anë të kontrollimit me gojë dhe me shkrim, ekzistojnë edhe shumë mënyra të tjera që mësimdhënësi mundet dhe duhet t'i zbatojë për të vlerësuar objektivisht jo vetëm rezultatet, por edhe procesin e të mësuarit. Në këtë kuptim, duke vëzhguar nxënësit, mësimdhënësi mund të ndjekë treguesit në vazhdim: mënyrën se si nxënësi merr pjesë në aktivitete, si mbledh të dhëna, si argumenton dhe si sjell përfundime. Veçanërisht tregues të rëndësishëm janë edhe cilësia e pyetjeve të parashtruara, aftësia për të gjetur lidhje midis fenomeneve, dhënja e shembujve, gadishmëria për të ndryshuar mendimin e vet në kontakt me argumentet, të bën dallimin e fakteve nga pohimet, të pranojë mendimin e tjetrit, të parashikojë pasojat dhe të jep zgjidhje kreative.

Gjatë ndjekjes dhe vlerësimit të të arriturave të nxënësve është e rëndësishme shfrytëzimi i portofolit të nxënësve. Ai paraqet një proces sistematik i dedikuar për mbledhjen dhe evaulimin e punimeve të nxënësve, duke dokumentuar kështu progresin e të arriturave dhe qëllimeve të të mësuarit ose për të treguar prova se objektivat e të nxënës janë arritur. Portofoli paraqet përmbledhje domethënëse të punimeve të nxënësve, progresin dhe të arriturat e tyre në fusha të caktuara. Mbajtja e një portofoli për të ndjekur dhe vlerësuar arritjet e nxënësve, mund të përmirësojë ndjeshëm komunikimin midis nxënësit, mësimdhënësit dhe prindit.

Për sa i përket ndjekjes dhe vlerësimit të nxënësve është e nevojshme të kombinohen mënyra të ndryshme të vlerësimit. Vetëm në këtë mënyrë mësuesi do të mund të njohë pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit. Gjatë çdo vlerësimi të të arriturave, nxënësit duhet t'i jepet informatë kthyese e cila do t'i ndihmojë atij të kuptojë gabimet e veta, të përmirësojë rezultatin, po edhe të mësuarit e tij. Informata kthyese duhet të jepet gjithmonë në kohë dhe duhet t'i referohet aktiviteteve dhe rezultateve të të nxënës në lidhje me nxënësin dhe jo me personalitetin e tij ose të saj. Nxënësi duhet të inkurajohet vazhdimisht në mënyra të ndryshme të mendojë për cilësinë e punës së tij dhe çfarë duhet të bëjë për të avancuar të mësuarit dhe për të përmirësuar arritjet e tij. Gjithsesi, rezultatet e ndjekjes dhe vlerësimit të përgjithshëm do të merren nga mësimdhënësi si bazë për planifikimin e hapave të mëtejshme në zhvillimin dhe përmirësimin e praktikës edukativo-arsimore.

**Sqarim:** Fondi i shfaqur më lartë për shfrytëzimin e orëve mësimore nga fushat dhe nënfushat programore është vetëm një propozim. Secili mësimdhënës, sipas kushteve në të cilat realizon programin e shkurtuar dhe sipas mundësive që kanë nxënësit, mundet në mënyrë të pavarur, sipas nevojës të përcaktojë fondin e orëve nga të gjitha fushat dhe nënfushat programore. Por, gjithsesi duhet të jenë **128 orë** mësimore të realizuara në **159 ditë**.

*Mjetet mësimore:*

- teksti shkollor i zgjedhur në nivelin të shkollës për lëndën përkatëse, i miratuar nga Ministri i arsimit dhe shkencës;
- Internet, softuer arsimor;
- web platforma për arsim;
- mjete audio-vizuale dhe mjete të tjera në varësi të temës;
- CD (tekste letrare);
- regjistrime audio dhe video;
- enciklopedi, fjalorë të ndryshëm, etj.;
- revista;
- revista tradicionale të certifikuara për fëmijë (revista të aprovuara);
- burime të tjera të të mësuarit në rrethinë të ngushtë: monumente kulturore, muze, shtëpi të kulturës, biblioteka, kinema, teatro, parqe kombëtare (përderisa e lejojnë kushtet), etj.

#### **4. Normativi për kuadrin mësimor**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadrin mësimor i paraparë në programin e rregullt mësimor.

Скратената наставна програма по наставниот предмет **Албански јазик** за **VII** одделение на деветгодишното основно образование ја утврди

Министер за образование и наука

Мила Царовска

Бр.12-8424/4

16.9.2020 година